



Duke u mbështetur në nenin 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 dhe nenit 15 pika 15.1.2.3 dhe 15.4 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Nr.04/L-174, Vendimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të miratuar nga KK 01Nr.350-1539/10 të dt.05.05.2010, Vendimit për Dhënie të Pëlqimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës, Nr.14/3306/1-ZSP/120/14 të dt 30.06.2014, Vendimit për dhënie të Pëlqimit në Planin Zhvillimor Komunal 2014-2021 të Klinës, Nr. 5835-2/14 të dt. 05.01.2015 nga MMPH, kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të dt.04.12.2014, Raportit të Punës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës me theks të veçantë në shqyrtimin publik janar 2014 me 06, Nr.350-3251/2014 të dt.13.06.2014, Raportit të Debatit me Publikun të dt. 10.12.2012- shkurt 2013, me Rekomandimet e KPF të dt.15.12.2014 dhe të dt.08.06.2015, si dhe Rekomandimit të fundit nga MMPH/MAPL të dt.06.11.2015, nr.0204-1471/6 për rishqyrtim, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e X-të të radhës për vitin 2015 të mbajtur më 26.11.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal - PZHK 2014-2021

I

MIRATOHET Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Klinës për periudhën 2014-2021, sipas Rekomandimit të fundit të dt.06.11.2015, Nr.0204-1471/6, ashtu që mbetet varianti i miratimit të vendimit bazë nga data bazë e 19.06.2015, duke hequr pikën 4 të atij vendimi.

II

Plani si në pikën një të këtij Vendimi është një Plan Strategjik multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjate të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor.

Plani përfshin: planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë se paku tetë (8) vjeçare.

III

Plani Zhvillimor Komunal përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës.

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kompetent është Drejtoria e Urbanizmit dhe MM.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb - faqen zyrtare të Komunës, kjo në kuptim të nenit 18 i Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 01/2013 dt.24.01.2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve Komunale.

V

Me këtë Vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria komunale e Urbanizmit dhe MM, MAPL, Kompania Urban Plus në Prishtinë përmes Drejtorisë, një kopje për ueb-faqen e Komunës, një kopje mbetet në Shërbimin për Punë të Kuvendit dhe një për Arkivin e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-5941 /2015
Klinë, më 26.11.2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Klinës pas shqyrtimit të Rekomandimit të fundit të MMPH/MAPL të dt.06.11.2015, Nr.0204-1471/6 vendosi për miratimin e PZHK-së sipas draft-Planit bazë të miratuar më dt.19.06.2015, duke hequr pikën 4 të atij vendimi dhe tani duke hequr edhe fjalën rishqyrtim nga vendimi i dt.25.09.2015. Meqenëse paraprakisht para vendimit bazë të dt.19.06.2015 kemi pasur pëlqimin paraprak nga MMPH, prandaj sipas kësaj situatë të krijuar është ndërruar vetëm titulli i vendimit siç u sqarua me lartë nga Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e X të radhës për vitin 2015 të mbajtur më dt.26.11.2015.

Andaj dokumentacionin me CD-n e PZHK-Klinë është i bashkangjitur me vendimin bazë të miratuar më dt.19.06.2015 si më poshtë:

1. Kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit të vitit 2010 për Inicimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal;
2. Vendimit të Kuvendit Komunal, 01Nr.350-1539/10 të dt.05.05.2010 për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal;
3. Vendimit për Dhënie të Pëlqimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës, Nr.14/3306/1- ZSP/120/14 të dt 30.06.2014;
4. Vendimit për dhënie të Pëlqimit në Planin Zhvillimor Komunal 2014-2021 të Klinës, Nr.5835-2/14 të dt. 05.01.2015 nga MMPH;
5. Kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe MM për miratim të Vendimit për PZHK nga Kuvendi Komunal - 01, Nr.351-5298/14 të dt.04.12.2014;
6. Raportit të Debatit me Publikun të mbajtur me 10.12.2012 deri në shkurt 2013,
7. Preferencave dhe rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa të dt.15.12.2014 dhe 08.06.2015.